



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

**K.P.P.714/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së BOE “DU&KO” shpk & “Alb Konstruksion” shpk dhe kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Riviera” shpk dhe “Artyka II” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-73988-06-07-2018 me objekt: “*Mirembajtje Rutine e Dimerore me Performance rruga Permet – Carshove – Tre Urat (Dogane) + rruga Carshove – Leskovik - Erseke + rruga Leskovik – Tre Urat (Dogane) 107 km*”, me fond limit 58 565 552 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 12.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Riviera” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:**

BOE “DU&KO” shpk& Alb –Konstruksion shpk  
Lagjia Nr.9, Rruga “11 Dëshmorët e Stanit”, Durrës

“Artyka II” shpk  
Rruga e Mirasit, Km I, pranë ish nyes së inerteve, Bilisht,  
Devoll.

**Autoriteti Kontraktor:**

Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster  
Ish Zona Industriale Gjirokaster

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. BOE “DU&KO” shpk& Alb –Konstruksion shpk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Ndërsa operatori ekonomik “Artyka II” shpk nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së BOE “DU&KO” shpk& “Alb –Konstruksion” shpk.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 07.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-73988-06-07-2018 me objekt: “*Mirembajtje Rutine e Dimerore me Performance rruga Permet – Carshove – Tre Urat (Dogane) + rruga Carshove – Leskovik - Erseke + rruga Leskovik – Tre Urat (Dogane) 107 km*”, me fond limit 58 565 552 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 12.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster.

II.2. Në datën 12.07.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 03.08.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Lurimi	pa ofertë	I skualifikuar
- Avdulli	pa ofertë	I skualifikuar
- Riviera	42,553,700	I kualifikuar
- Artyka II	42,988,640	I kualifikuar
- DU& KO	51,659,200	I skualifikuar
- 2T	52,709,000.00	I kualifikuar
- Gjiguria	53,295,960	I kualifikuar
- Alb Korca 2002	53,689,300	I skualifikuar

II.4. Në datën 03.08.2018 BOE DU&KO” shpk& “Alb –Konstruksion” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Bashkimi i Operatoreve ekonomik Du & Ko shpk & Alb Konstruksion shpk, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte: Operatori ekonomik Alb Konstruksion shpk, pjese e ketij bashkimi, sipas kontrates se bashkepunimit ka marre persiper te kryej 80% te sherbimeve. Ne kundershtrim me piken 2.3.12 te dokumenteve te tenderit ku percaktohet se "Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik...cdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, ne perpjestim dhe perputhje me punet e marrra perisiper sipas marrevshjes se bashkepunimit", ky operator nuk disponon kategorine perkatese ne licencen profesionale NP – 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit.*
- *Operatori ekonomik Du & Ko shpk, pjese e ketij bashkimi nuk ploteson kriterin 2.3.1 te dhene ne dokumentet e tenderit ku thuhet "Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar sherbime të ngjashme mirembajtjeje rutine e dimerore rrugeshe në një vlerë jo më pak se 40% e fondit limit qe prokurohet dhe që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit", ne raport me percaktimin e dhene ne piken 2.3.12. "Nëse oferta dorëzohet nga një*

*bashkim operatorësh ekonomik, duhet te dorezohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, ne perpjestim dhe perputhje me punet e marrra perisiper sipas marrevshjes se bashkepunimit. Kontrata e paraqitur nuk eshte e ngjashme me " mirembajtjeje rutine e dimerore rrugesh".*

- *Ne vërtetimin e paraqitur që konfirmon shlyerjen e pagesave te energjise elektrike, rezulton qe Operatori ekonomik Alb Konstruksion shpk, ne kundërshtim me piken 1/d te kriterëve te veçanta per kualifikim nuk ka shlyer detyrimet të maturuara të energjisë elektrike te muajit maj 2018. (Mbi detyrimet e maturuara sipas Vendimit te ERE-s, Nr.109, date 21.10.2011, "Per miratimin e kontratës se furnizimit me energji elektrike te klientëve jofamiljare, neni 9/1, Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.")*

II.5. Në datën 09.08.2018 BOE DU&KO" shpk& "Alb –Konstruksion" shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit sqarojmë se në marrëveshjen e bashkëpunimit janë përcaktuar qartë zërat e punimeve dhe deri në çfarë vlere merr përsipër secili nga operatorët ekonomikë në raport me vlerën e ofertës. Nëse analizohen të gjitha zërat e shërbimeve në preventiv kuptohet qartë se të gjitha shërbimet që kanë lidhje me inxhinierinë e mjedisit janë marrë përsipër nga ana e subjektit DU&KO shpk dhe nuk janë marrë përsipër nga shoqëria Alb Konstruksion e cila nuk është e pajisur me licencën NP-12/A. DU&KO shpk ka paraqitur licencën e vet për punimet në inxhinierinë e mjedisit ndaj dhe arsyeja e ngritur për skualifikim nuk qëndron.*
- *Për sa i përket kontratave të ngjashme të paraqitur nga DU&KO shpk besojmë se nga KVO është keqinterpretuar koncepti gjuhësor i kontratës së ngjashme duke mos kuptuar si të ngjashëm zërat e shërbimeve që janë pasqyruar në preventiv por vetëm titullin e kontratës. Pavarëisht si është titulluar kontrata jonë që është paraqitur si eksperiencë e ngjashme nëse do shihen një për një zërat e shërbimeve të kryera besojmë se jemi konform plotësisht të kriterit të kërkuar nga AK. Nqs se i referohemi zërave në anekset e kontratës shohim natyra e shërbimeve të kryera është e njëjtë dhe e ngjashme me shërbimet që operatori ekonomik merr përsipër sipas Akt marrveshjes së bashkëpunimit, volumet dhe vlerat e këtyre shërbimeve i kalojnë disa herë në sasi dhe në vlerë 40 % e kontratave të ngjashme të kërkuar në kriterin e kualifikimit.*
- *Për sa i përket arsyes së tretë të skualifikimit sqarojmë se nga ana e subjektit Alb Konstruksion është paraqitur vërtetim debie Nr. Prot 1403 datë 13.06.2018 për të plotësuar kriterin 1 d. Sipas këtij vërtetimi specifikohet qartë që deri nëmomentin e lëshimit të tij ky subjekt ka 0 detyrime (ose nuk ka asnjë detyrim) pra konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në shqipëri. Fizikisht fatura e muajit maj 2018 ku pasqyrohen detyrimet e abonentit shpërndahen në fund të muajit pasardhës (në fund të qershorit 2018) nga sa kuptohet fatura e muajit maj 2018 nuk kishte dalë akoma në*

*momentin e tërheqjes së këtij vërtetimi. Sqarojmë se vërtetimi i paraqitur është brenda formatit, brenda afateve ligjore të përcaktuara dhe përmbajtja e tij plotëson kushtin 1 d pasi fatura e muajit maj për shkak se nuk ishte hedhur në sistem e për rrjedhojë nuk na është vënë në dispozicion për tu paguar gjë që del qartë edhe në vërtetim ku nuk është klasifikuar si detyrim i papaguar për sa kohë që nuk është gjeneruar dhe dorëzuar tek debitori. Në kushtet kur fatura nuk është hedhur në sistemin e detyrimeve të OSHEE nuk ka si të klasifikohet si titull ekzekutiv. Në cdo kohë ne mund të vëmë në dispozicion rregullsinë e shlyerjes së detyrimeve ndaj OSHEE. Nqs se KVO do i duhen informacione shtesë për gjithë pretendimet e ngritura nga ana jonë jemi të gatshëm ti vëmë në dispozicion.*

*2. Për OE Riviera konstatojmë disa shkelje ligjore ndaj dhe duhet të skualifikohet:*

- OE Riviera ka paraqitur Bilancin e vitit 2017 por ky bilanc rezulton me humbje për periudhën 01.01.2017-31.12.2017 duke rënë në kundërshtim me kriteret e vendosura nga AK.*
- Subjekti Riviera nuk ka paraqitur pagesën e taksave vendore pranë Bashkisë Kolonjë ku edhe gjatë vitit 2017 ka ushtruar veprimtarinë e saj ku ka pasur edhe Nipt sekondar*
- Nuk ka paraqitur pagesën e taksave vendore pranë Bashkisë Mat , Malësi e Madhe,*
- Kontratat e paraqitura nga OE Riviera i mungojnë zërat e ngjashëm si mirëmbajtje dimërore dhe largim bore. Nuk plotëson kushtin për kontrata të ngjashme.*
- Nuk plotëson kriterin 2.3.5 për mjek pasi dokumentacioni i paraqitur nga ana e subjektit është fotokopje e noterizuar.*
- Nuk plotëson kriterin në pikën 2.3.7 lidhur me mjetet: mjeti tip autobitumatrice me targë AA230HV i dorëzuar si i tillë pranë AK rezulton kamion 3.5-7.5 ton.*
- Mjeti tip fadromë me gomë ACMT 26 po ashtu ka probleme em dokumentacionin.*
- Kontrata e qerasë për mjetin asfaltoshtruese është e pavlefshme sepse për të njëjtën periudhë kohore i është dhënë një subjekti me qera që aktualisht kryen punë pranë AK dhe ky fakt është lëhtësisht i verifikueshëm.*
- Nuk disponon asnjë mjet borëpastrues në pronësi ose me qera të regjistruar në RSH.*

*3. Për sa i përket BOE ArtykaII&Avdolli shpk: Nuk plotëson kriteret e duhura teknike dhe ka plotësuar në mnëyrë të parregullt ose ka falsifikuar shtojcën 5 deklarata për fuqitë punëtore dhe makineritë duke bërë deklaram të rremë për këto të fundit. Sipas DST të kësaj procedure OE ka plotësuar deklaratën se asnjë nga punonjësit (25 të kërkuar në total) dhe asnjë nga makineritë e paraqitura nga ky OE nuk do të angazhoheshin në asnjë procedurë tjetër prokurimi. Kontrata e paraqitur si kontratë e ngjashme nuk i ka mbaruar efektet ligjore. Administratori ka paraqitur një deklaratë të rremë pasi këto makineri janë të angazhuara edhe në kontrata të tjera të papërfunduara qoftë edhe me ju si AK. Për këtë mjafton një verifikim i thjeshtë. Për më tepër Artyka II është shpallur fitues në një procedurë tjetër prokurimi me Bashkinë Devoll e cila ka filluar efektet më datë 10.07.2018. OE rezulton me punësim mesatar 40 punonjës. Nga këta 25 janë ende të punësuar në zbatimin e kontratës me objekt Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë aksi rrugor K/Liqenas-Dogana Gorricë 16.4 km. Subjekti Artyka II ka tejkaluar kapacitetet e veta teknike dhe ka paraqitur deklarata të rreme me qëllim kualifikimin në këtë procedurë prokurimi.*

*- Subjekti Avdolli pjesë e këtij bashkimi ka lidhur kontratën me nr.4211/5 datë 19.08.2016 me objekt mIrëmbajtje rutinë dhe dimërore aksi rrugor K/Zemblak –K Liqenas 17 km me ARSH me*

*afat 2 vjet. Në momentin e zhvillimit të procedurës por edhe në momentin që flasim kontrata nr.4234 prot datë 31.08.2016 nuk i ka mbaruar efektet financiare. Pjesa më e madhe e stafit teknik dhe e punonjësve të kësaj kompanie rezulton e punësuar në këtë procedurë prokurimi dhe makinieritë janë paraqitur dhe të angazhuara në kontratën Nr.4211/5 datë 19.08.2016.*

II.6. Në datën 10.08.2018 me shkresën nr. 546 prot, BOE ankimues është vënë në dijeni në lidhje mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 23.08.2018, pala ankimuese BO“DU&CO” sh.p.k& “Alb Konstruksion” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 07.08.2018 BOE “Artyka II” shpk& “Avdolli” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik “Riviera” shpk

II.9. Në datën 13.08.2018, me shkresën nr.549 prot, BOE Artyka&Avdolli shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.10. Në datën 24.08.2018 pala ankimuese BOE Artyka&Avdolli shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr.609 prot, datë 03.09.2018 protokolluar me tonën me nr.1428/2 prot datë 07.09.2018 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Në lidhje me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “BOE DU&KO” shpk& “Alb –Konstruksion” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se *“Ne vërtetimin e paraqitur që konfirmon shlyerjen e pagesave të energjisë elektrike, rezulton që Operatori ekonomik Alb Konstruksion shpk, në kundërshtim me piken 1/d të kriterëve të veçanta për kualifikim nuk ka shlyer detyrimet të maturuara të energjisë elektrike të muajit maj 2018. (Mbi detyrimet e maturuara sipas Vendimit të ERE-s, Nr.109, date 21.10.2011, “Per miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljare, neni 9/1, Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 1/d të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi kërkohet:

*Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

III.1.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni konstaton se anëtrai i bashkimit të përkohëshëm të operatorëve ekonomikë ankimues Alb –Konstruksion në përmeshje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

➤ Vërtetim Debie Nr. 1403 Prot datë 13.06.2018 në të cilin citohet se: *vërtetohet se kërkuesi Alb Konstruksion shpk nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontratën me kod SHOB110208044706 titullar i të cilës është Alb Konstruksion rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datën 13.06.2018 **pa përfshirë faturën koherente të muajit Maj 2018.***

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmeshur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.4 Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.5. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 4, gërma “ç” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet : *[...]Për të provuar përmeshjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rasti kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”*

III.1.6. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*

III.1.7. Referuar korenspondencës mbajtur midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, nga kjo e fundit është konfirmuar se, pasi bëhen verifikimet përkatëse në sistemin e faturimit, lëshohet “*Vërtetim Debit*” sipas formatit standart për të gjitha subjektet aplikuese. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë elektrike, evidenton saktësinë e dokumentacionit, të paraqitur nga subjektet përkatëse si dhe tërësine e kontratave, dhe në fund konkludon me lëshimin e “*Vërtetim Debit*” i cili konfirmon se:

1. *Konsumatori nuk rezulton debitor në sistemin e furnizimit*
2. *Konsumatori rezulton debitor*
3. *Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur akt-marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.*

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomik ankimues “Alb Konstruksion” shpk rezulton se ka paraqitur një dokument sipas *formatit standard* lëshuar nga OSHEE i cili vërteton se janë shlyer detyrimet e energjisë elektrike deri në muajin Prill pa përfshirë faturën koherente të muajit Maj. Referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi 12.07.2018 KPP gjykon se anëtarit të bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë ankimues Alb Konstruksion shpk i ka lindur detyrimi për të shlyer pagesën e energjisë elektrike për muajin Maj 2018 pasi në kuptim të dispozitave ligjore të sipërcituara detyrimet për këtë muaj janë maturuar tashmë.

Në këtë kuptim KPP gjykon se me anë të dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomik ankimues “Alb Konstruksion” shpk nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit pasi me anë të këtij dokumenti nuk vërtetohet shlyerja e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, për periudhën më të fundit, para hapjes së ofertave, që tashmë ishte maturuar.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qendron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “DU&CO” sh.p.k& “Alb Konstruksion” shpk” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit mësipër, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

III.3. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “DU&CO” sh.p.k & “Alb Konstruksion” mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Riviera” shpk, si dhe BOE ArtykaII&Avdolli shpk, KPP sjell në vëmendje nenin pika 1, të LPP i cili parashikon shprehimisht: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*”

Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.



Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet nuk merren në shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Artyka II” shpk & “Avdolli” shpk lidhur me skualifikimin skualifikimin e operatorit ekonomik “Riviera” shpk Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në datën 03.08.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Lurimi	pa ofertë	I skualifikuar
- Avdolli	pa ofertë	I skualifikuar
- Riviera	42,553,700	I kualifikuar
- Artyka II	42,988,640	I kualifikuar
- DU& KO	51,659,200	I skualifikuar
- 2T	52,709,000.00	I kualifikuar
- Gjiguria	53,295,960	I kualifikuar
- Alb Korca 2002	53,689,300	I skualifikuar

III.4.2. Në datën 07.08.2018 BOE “Artyka II” shpk& “Avdolli” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik “Riviera” shpk

III.4.3. Në datën 13.08.2018, me shkresën nr.549 prot, BOE “Artyka” & “Avdolli” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

III.4.4. Në datën 24.08.2018 pala ankimuese BOE “Artyka” & “Avdolli” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t`ia njoftojë ankuesit jo

*më vonë se në ditën vijuese të punës*”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.4.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit rezulton se ankesa e operatorit ekonomik ankimues është pranuar nga autoriteti kontraktor në datë 07.08.2018 fakt i cili provohet edhe nga informacioni i autoritetit kontraktor si dhe nga shkresa kthim përgjigje nr.549 prot datë 13.08.2018 drejtuar ankimuesit nga autoriteti kontraktor. Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar” *strictu sensu* parashikohet se ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim *brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor*. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme të punës pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së. Me marrjen e ankesës në dorëzim nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka detyrimin ligjor të shqyrtojë ankesën dhe të marrë një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve nga dita e marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës. Sa më sipër, K.P.P. konstaton se ankimi i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë 24.08.2018 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituar, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor dhe përfundon ditën e dhjetë. Në rastin konkret, afati maksimal i paraqitjes së ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e operatorit ekonomik ankimues është datë 23.08.2018.

III.4.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga BOE “Artyka” shpk & “Avdolli” shpk pranë K.P.P. nuk ka respektuar afatet e ankimit, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.4.8. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të

vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “DU&CO” sh.p.k & “Alb Konstruksion” për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-73988-06-07-2018 me objekt: “Mirembajtje Rutine e Dimerore me Performance rruga Permet – Carshove – Tre Urat (Dogane) + rruga Carshove – Leskovik - Erseke + rruga Leskovik – Tre Urat (Dogane) 107 km”, me fond limit 58 565 552 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 12.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster.
2. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Artyka” & “Avdolli” shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1428 Protokoli ; Datë 23.08.2018**

**Nr.1429 Protokoli; Datë 24.08.2018**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**

